



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
KËSHILLI KOMBËTAR



Tiranë më, 16.12.2022

V E N D I M

Nr.26, datë 16.12.2022

Në mbështetje të ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenin 13.1), të këtij ligji;

Bazuar në nenin 42, pika 1 të Statutit të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë;
Këshilli Kombëtar

VENDOSI:

1. Të miratojë me unanimitet të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje, Projekt-Buxhetin e vitit financiar 2023.
2. Bashkëngjitur këtij Vendimi gjeni relacionin e zyrës financiare dhe Projekt-Buxhetin e miratuar.

PRESIDENTE E URDHRI

Dr. Valbona TRESKA



SEKRETARE

Armira BABOÇI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
ZYRA E FINANCËS



Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, kati II, Ap.9, Tiranë, email: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 00355 04220 9927

Tiranë, më 07.12.2022

Lënda: RELACION PËR PROJEKT BUXHETIN 2023

1. Informacion i përgjithshëm

Tashmë në vitin e gjashtë të funksionimit të institucionit, janë hedhur baza të shëndosha jo vetëm për mbledhjen e të ardhurave stabël, por edhe lidhur me shpërndarjen e këtyre të ardhurave në zëra të ndryshëm të buxhetit sipas nevojave për mbarëvajtje. Bazuar në shpenzimet faktike të këtyre viteve dhe vecanërisht të vitit 2022, është hartuar edhe ky buxhet, i cili këtë vit parashikon disa zëra dhe shpenzime shtesë, të cilat vlerësohen domosdoshmëri në garantimin e vazhdimësisë institucionale dhe qëndrueshmërisë.

Ndonëse nuk kemi ende një buxhet faktik zyrtar të këtij viti, nga mbledhja e të ardhurave të deritanishme, shfaqet qartë që kemi një përmbushje të pritshmërisë së mbledhjes së të ardhurave deri në 01.12.2022. Aktualisht këto të ardhura janë në **masën 15,530,000.00**. Në projekt buxhetin e vitit 2022 është parashikuar mbledhje e të ardhurave në masën **14,880,000.00 lekë**. **Pra aktualisht kemi tejkalim të të ardhurave në masën rreth 104% deri në fillim të Dhjetorit 2022.**

Nga këto të ardhura kemi rreth 8,500,000.00 lekë nga kuotizacionet e anëtarësisë, sipas kategorizimeve të miratuara nga Këshilli Kombëtar në dhjetor 2021 si dhe 658,845.00 lekë nga regjistrimet dhe ri-regjistrimet.

Përkatësisht:

Regjistrime/ri-regjistrime: 340 anëtarë në total në masën e 658,845.00 lekë (2,000.00 lekë x 340 regjistrime të reja)

Kuotizacione: 71 anëtarë ekspertë *ligjorë* në masën e 993,000.00 lekë (15,000.00 lekë x 71 anëtarë)

Kuotizacione: 720 anëtarë *licencuar* në masën e 4,335,415.00 lekë (6,000.00 lekë X 720 anëtarë)

Kuotizacione: 712 anëtarë *praktikantë* në masën e 3,170,990.00 lekë (4,500.00 lekë X 712 anëtarë)

Ndërkohë që kemi një mbledhje të ardhurash të konsiderueshme nga licencimet e reja dhe ri-licencimet si dhe nga provimi i praktikës VAP.



Licencime: 224 anëtarë në masën e 3,356,445.00 lekë (15,000.00 lekë licencimi X 224 anëtarë)

Të ardhura nga provimi i praktikës (V.A.P): në masën e 669,565.00 lekë (3,000.00 lekë X 224 anëtarë)

Ka patur një mbledhje të konsiderueshme të të ardhurave në masën rreth 2,500,000.00 lekë nga Edukimi në Vazhdim. Në Projekt-Buxhetin e vitit 2022 këto të ardhura parashikoheshin të ishin në masën 1,000,000.00 lekë (10 kredite X 500 anëtarë).

Në këto kushte shfaqet qartë se objektivat financiare të institucionit për vitin 2022 janë përmbushur dhe tejkaluar, pa përlogaritur të ardhurat e muajit dhejtor 2022, ndaj gjatë këtij viti financiar, është vlerësuar të ndërmerren disa politika për funksionimin sa më të mirë të institucionit në përputhje me nevojat, duke ruajtur dhe patur gjithmonë në konsideratë stabilitetin financiar.

Pas përmbushjes së detyrimeve financiare përgjatë vitit 2022, parashikohet që nga të ardhurat e mbledhura, një shumë prej rreth 3.500.000 lekë të jetë e pashpenzuar dhe t'i kalojë vitit pasardhës. Një pjesë e kësaj shume do të shpërndahet në zëra të tjerë të nevojshëm të Projekt-Buxhetit dhe një pjesë prej rreth 2,500,000.00 lekë parashikohet të kalohet në një zë të ri nën termin "fonde rezerve", një shpjegim më i detajuar i të cilit do të bëhet në vijim.

Shpërndarja e të ardhurave të parashikuara në zëra të vecantë të buxhetit, përfshirë edhe fondin e pagave të punonjësve të UP, synon të mbajë të balancuar nevojat e shtuara të institucionit si pasojë e zgjerimit të tij, në përputhje me të ardhurat që parashikohen të përftohen gjatë vitit fiskal 2023.

2. Objektivat strategjikë të Urdhrit në vitin fiskal 2023 janë:

- Rritja e anëtarësimeve, licencimeve dhe rilicencimeve në Urdhrin e Psikologut, nëpërmjet ndërgjegjësimit, sensibilizimit dhe rritjes së bashkëpunimit me institucionet. Realizimi i provimit të shtetit si një detyrim ligjor që rrjedh nga Ligji Nr.10171 datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, parashikohet që të realizohet 2 (dy) herë gjatë këtij viti fiskal.
- Fuqizimi i rolit dhe statusit të psikologut në institucione, nëpërmjet hapjeve të vendeve të reja të punës, vecanërisht në fushën e shëndetit mendor dhe edukimit.
- Fuqizimi dhe përmirësimi i sistemit të Edukimit në Vazhdim për psikologët. Implementimi të dhënave të psikologëve për Edukimin në Vazhdim në një regjistër të dedikuar, i cili do të kryqëzohet me të dhënat në regjistrin online aktual.
- Rritja e bashkëpunimit në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke synuar vijimin e procedurave për licencimin në EUROPSY si dhe aktivizimin e faqes së re të ëeb europsy.al si detyrim që rrjedh nga procedurat për Europsy.



3. Të ardhurat që parashikohen për 2023

Projekt-Buxheti i vitit 2023 parashikon mbledhjen e të ardhurave në masën 21,520,000.00 lekë.

Nisur nga pritshmëria se në vitin 2023 parashikohen rreth 250 regjistrime të reja dhe 50 ri-regjistrime, e cila duke u bashkuar edhe me anëtarësinë ekzistuese kuotizacionet parashikohen rreth 9,270,000.00 lekë për vitin 2023.

Përlllogaritja e të ardhurave parashikohet të jetë:

Regjistrime/ri-regjistrime: 300 anëtarë në total në masën e 600,000.00 lekë (2,000.00 lekë x 300 regjistrime të reja)

Kuotizacione: 80 anëtarë ekspertë *ligjorë* në masën e 1,200,000.00 lekë (15,000.00 lekë x 80 anëtarë)

Kuotizacione: 820 anëtarë të *licencuar* në masën e 4,920,000.00 lekë (6,000.00 lekë X 820 anëtarë)

Kuotizacione: 700 anëtarë *praktikantë* në masën e 3,150,000.00 lekë (4,500.00 lekë X 700 anëtarë)

Licencime: 300 anëtarë në masën e 4,500,000.00 lekë (15,000.00 lekë licencimi X 300 anëtarë)

Edukimi në vazhdim: në masën e 3,000,000.00 lekë (15 kredite X 1000 anëtarë)

Të ardhura nga provimi i praktikës (V.A.P): në masën e 600,000.00 lekë (3,000.00 lekë X 200 anëtarë)

Të ardhura të tjera të ligjshme: në masën 50,000.00 lekë (vërtetime, Kodi i Etikës)

Rezerva nga viti i kaluar 2022: në masën 3,500,000.00 lekë ✓

Rezerva e këtij viti është 2.5 herë më e lartë se rezerva që akumuluar në vitin fiskal 2021.

4. Shpenzimet e parashikuara për vitin 2023

Nisur nga eksperiencia e vitit të kaluar, për efekt të disiplinimit sa më transparent të të ardhurave, kemi ruajtur një balancë të shpenzime të detyrueshme për t'u realizuar sipas planifikimit.



Emërtimi	Vlera	Monedha
Rezerva nga viti i kaluar 2022	3,500,000.00	ALL
Të ardhura	18,020,000.00	ALL
Total	21,520,000.00	ALL
Shpenzime për :		
Paga	7,155,600.00	ALL
Shpenzime Operative	10,864,400.00	ALL
Shpenzime Kapitale	1,000,000.00	ALL
Total	19,020,000.00	ALL
Diferenca / Fondi Rezerve	2,500,000.00	ALL

4.1 Pagat e punonjësve të UP.

Për vitin e ardhshëm parashikohet të aplikohet një rritje e pagave për punonjësit e administratës së Urdhrit në masën 15.5 %, ndërsa Presidenti i U.P. në masën rreth 13%.

Kjo rritje e pagave bëhet për shkak të rritjes këtë vit të inflacionit, i cili aktualisht duke u bazuar në të dhënat e Bankës Kombëtare është në masën 9.3 %¹. Gjithashtu edhe nga të dhënat e INSTAT, inflacioni aktualisht për këtë vit kap vlerën 8.3 %².

Bazuar në kushtet aktuale të këtij inflacioni të referuar nga institucionet publike, bazuar në rritjen progresive të pagave të institucioneve publike dhe jopublike që është aplikuar në masë për shkak të inflacionit, si dhe me qëllim stimulimin e punonjësve të Urdhrit të Psikologut, në një periudhë kur fluksi i punës është shtuar, si pasojë e numrit të lartë të anëtarëve, shtimit të numrit të komisioneve dhe vlerësimeve që kryhen për anëtarët e Urdhrit, etj, propozohet kjo rritje pagash.

Për nevoja të përmbushjes së detyrave brenda institucionit, Specialisti i Zyrës së IT planifikohet, që duke filluar nga viti i ardhshëm të ushtrojë detyrën me kohë të plotë me pagë bruto në masën 70,100.00 lekë. Ushtrimi i detyrës me orë të reduktuara, bazuar në vendimin e mëparshëm të organigramës së Këshillit.Kombëtar, është aktualisht aspak në përshtatje me nevojat mjaft të shtuara të institucionit. Jemi aktualisht me një faqe ëebi plotësisht dinamike, një faqe ëeb të Europsy që duhet të aktivizohet, tre regjistra online funksionalë, menaxhimin e aplikimeve online, hedhje dokumentacioni në ëeb të anëtarëve të rinj, etj. Në kushtet kur në

¹ https://ëëë.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Objektivi_dhe_strategjia/
Shkarkuar me 07.12.2022

² <http://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pagat/publikimet/2022/statistikat-e-pagave-t2-2022/>

Shkarkuar me 07.12.2022



sajë të avancimit drejt digjitalizimit të sistemit, i cili, duhet të shkojë në proporcion të drejtë me fluksin e shtuar të punës, është domosdoshëmi vendosja e punonjësit IT me kohë të plotë.

4.2 Sekretari i Përgjithshëm

Bazuar në zgjedhjet e KK, që prej janarit 2023 organika e Urdhrit të Psikologut, do të plotësohet edhe me përfshirjen e Sekretarit të Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 36/1 të Statutit të Urdhrit të Psikologut. Pas Vendimit Nr.23 datë 08.11.2022 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut u zgjodh edhe Sekretari i Përgjithshëm i Urdhrit të Psikologut, me mandat 5-vjeçar. Për vitin e ardhshëm është planifikuar që shpenzimet në Buxhet për rrogën e Sekretarit të Përgjithshëm, të jenë në vlerën 65,200.00 lekë bruto kjo pasi për momentin, duke mbajtur në konsideratë shpenzimet në buxhet dhe politikat e institucionit të dakordësuara më parë në diskutimet e Këshillit Kombëtar, Sekretari i Përgjithshëm i Urdhrit të Psikologut do të ushtrojë funksionin e tij për jo më shumë se 25 orë në javë.

4.3 Shpenzime që lidhen me Edukimin në Vazhdim

Vitin e ardhshëm sa i përket Edukimit në Vazhdim, është planifikuar që të kemi një punonjës të ri me kohë të plotë, i cili do t'i dedikohet tërësisht procesit të Edukimit në Vazhdim, kjo për arsye se:

- 1) Numri i qendrave apo institucioneve që ofrojnë aktivitete të Edukimit në Vazhdim aktualisht është shumë i lartë krahasimisht me vitet e kaluara.
- 2) Procesi i Edukimit në Vazhdim ka të domosdoshme koordinimin e punëve ndërmjet qendrave, ekspertëve të jashtëm dhe Komisionit të Edukimit në Vazhdim, ndaj prezenca e një specialisti të posaçëm për menaxhimin e gjithë këtij procesi është i domosdoshëm.
- 3) Numri i aplikimeve të psikologëve, të cilëve u ka përfunduar afati i vlefshmërisë së licencës është shumë i lartë, për këtë arsye specialisti i Edukimit në Vazhdim, duhet të jetë vazhdimisht i përditësuar me aplikimet e anëtarëve dhe vlerësimet që kryen Komisioni i Edukimit në Vazhdim lidhur me kërkesat e tyre për rilicencim, për të mbështetur në mënyrë të vazhdueshme punën e komisionit.
- 4) Duhet mbajtur në konsideratë se i gjithë procesi i Edukimit në Vazhdim është një proces shumë i gjerë, i cili për analogji me Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim për Profesionistët e Shëndetësisë (KEVP) e cila ka një administratë të tërë, ka një alokim të konsiderueshëm fondesh buxheti i shtetit. Deri më tani kjo punë është realizuar vetëm nga administrata aktuale e UP, por prej më shumë se një viti fluksi është bërë i papërballueshëm, duke bërë që shpesh të lihen mënjanë punë dhe korrespondenca shumë të rëndësishme për institucionin, vetëm me qëllim dedikimin ndaj Edukimit në Vazhdim.



Urdhri i Psikologut
Republika e Shqipërisë

Në këto kushte, për mbarëvajtjen e akreditimeve dhe rilicencimeve, vendosja e një specialisti në organigramë në këtë pozicion, është domosdoshmëri.

4.4 Fondi Rezervë

Këtë vit Urdhri i Psikologut me qëllim krijimin e një sigurie dhe stabiliteti financiar do të krjojë një fond rezervë, i cili do të jetë i shfrytëzueshëm vetëm në rastet e nevojshme. Ky fond fillimisht për vitin 2023 është planifikuar të jetë në vlerën 2,500,000.00 Lekë. Me kalimin e viteve planifikojmë që vlera e këtij fondi të rritet, si pasojë e shtimit të të ardhurave që ne synojmë në vazhdimësi. Krijimi i Fondit Rezervë do të krijojë një mburojë sigurie për insitucionin e Urdhrit të Psikologut me qëllim mirëfunksionimin e tij në të ardhmen, ndaj çdo problematike apo rasti emergjent dhe të paparashikuar, me të cilin insitucioni mund të përballet në të ardhmen dhe që për të cilën nuk ka të planifikuar një zë të posaçëm në buxhet.

4.5 Shpenzime operative

Në zërin e **shpenzimeve operative**, janë parashikuar disa rritje të zërave si më poshtë, bazuar në vitet e kaluara, shpenzimet bazë si kancelari, softëare dhe programim, shpenzime për ekspertë të jashtëm, shpenzime për aktivitete për marrëdhënie kombëtare dhe ndërkombëtare, shpenzime për detyrime të pjesëmarrjes në organizata Shpenzime ligjore, noteriale, etj., shërbime për honorare, etj.

Të gjitha zërat e rritur në shenzimet operative, kanë ardhur si nevojë e shtimit të fluksit të punës si dhe nevojës për të bërë një shpërndarje më të plotë dhe efikase në funksion të shpenzimeve të patura edhe gjatë vitit fiskal 2022.

PËRMBLEDHËSE

Projekt buxheti i vitit 2023 ruan një balancë të qëndrueshme midis të ardhurave dhe shpenzimeve, duke vijuar ruajtjen e stabilitetit ekonomik të institucionit, si dhe reflekton ambicien për të kaluar në një fazë të re të funksionimit të Urdhrit, me qëllim që aktiviteti i tij të bëhet sa më i ndjeshëm në politikat kombëtare dhe ndërkombëtare, të jetë sa më i prekshëm për anëtarësinë dhe, mbi të gjitha, të përmbushë misionin ligjor për të cilin është krijuar në bazë të ligjit 40/2016 për “Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”.

Zyra e Financës

Lejdi Goga